Kronikë

Lushnjë/ Tentoi të grabiste bagëtitë, hajduti plagos me armë gjahu të zotin e stanit (VIDEO)

Një 65-vjeçar i cili tentoi të vidhte bagëtitë në një shtëpi në Plug ka rënë në prangat e policisë

Redaksia
16 Prill, 10:49 | **Përditesimi: 16 Prill, 13:42**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Lushnjë- Një tentativë grabitje ka ndodhur në orët e para të mëngjesit në Lushnjë.

Një 65-vjeçar i cili tentoi të vidhte bagëtitë në një shtëpi në Plug ka rënë në prangat e policisë.

Dedë Dedaj pasi është pikasur nga i zoti i shtëpisë, Flamur Mane është përleshur me të madje edhe e ka qëlluar me armë gjahu.

LEXO EDHE:
Kandidatja e PS vijon ironitë me Bardhin dhe e fton për drekë: Eja të pres me shoqet

Pas incidentit Mane ka njoftuar policinë që bënë të mundur edhe kapjen e hajdutit, gjithashtu banues në Plug.

Ndërkohë i plagosuri ndodhet te Trauma jashtë rrezikut për jetën.

Burime për Report Tv kanë thënë se edhe disa disa ditë më parë, Flamur Manes i kanë vjedhur disa bagëti në stanin e tij.

Njoftimi i policisë:

Menjëherë pas kallëzimit të shtetasit F. M., 66 vjeç, se gjatë natës, sapo një shtetas kishte hyrë për të vjedhur në kasollen në pronësi të tij, ai e kishte konstatuar dhe gjatë konfliktit me të, autori i tentativës për vjedhje e kishte qëlluar me armë gjahu, shërbimet e Komisariatit të Policisë Lushnjë kanë organizuar punën për kapjen e autorit.

Si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore dhe policore, u identifikua dhe u kap autori i dyshuar i rastit, shtetasi D. D., 65 vjeç.

I dëmtuari, shtetasi F. M., ka marrë asistencë mjekësore dhe është jashtë rrezikut për jetën.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Fierit, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: lushnje | Fier | vjedhje | Dedë Dedaj | Flamur Mane

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 14 Prill, 22:09
A duhet t'u jepet mundësia prokurorëve të SPAK të rikandidojnë?
Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

I dënuar më parë për 65 vjedhje, dëbohet shqiptari nga Italia
16 Prill, 18:39

Përplasja me agjentët e BKH-së, Report TV siguron pamjet e kompanisë së vëllait të Agron Kapllanajt
16 Prill, 13:57

Kakavijë/ E dënuara me 1 vit burg për vjedhje në Vlorë kapet në kufi! Nën akuzë dhe 38-vjeçari që udhëtonte drejt Greqisë me 11100 euro cash
16 Prill, 13:11

Përplasja me agjentët e BKH dhe efektivët/ Kapllanaj për Report TV: Nuk u identifikuan, njëri prej tyre shau dhe kërcënoi! Nxorri dhe armën! S'ka pasur as sulm as goditje
16 Prill, 12:18

Përplasja me agjentët e BKH-së në Fier, arrestohen 2 nipërit e Agron Kapllanajt dhe një tjetër
16 Prill, 09:02



Përplasje mes njerëzve të Agron Kapllanajt dhe agjentëve të BKH në Fier! Policia: U goditën për shkak të detyrës! Rrethanat të paqarta, disa të shoqëruar
15 Prill, 22:07

Vlorë/ 'Nga vjedhja në vjedhje', 53-vjeçari thyen masën e arrestit shtëpiak, kapet 'mat' duke grabitur furgonin (EMRI+VIDEO)
15 Prill, 11:28

Vdekja e elektriçistit në Divjakë, në pranga 2 elektricistë të OST dhe OSHEE
15 Prill, 10:12

U arratis me të dashurin pas plagosjes me armë të bashkëshortit të saj, e reja vetëdorëzohet në Policinë e Fierit: U fsheha në Krujë! Autori ende në kërkim
15 Prill, 10:00

Divjakë/ Ra në kontakt me energjinë elektrike teksa po punonte, ndërron jetë elektriçisti 32- vjeçar
14 Prill, 16:25

Nisin aplikimet për subvencione në bujqësi, ankohen fermerët: Ka burokraci, dokumente shtesë për sipërfaqen e tokës së mbjellë
14 Prill, 15:14

Zgjedhjet/ 500 euro në këmbim të votës për Berishën, në pranga 38-vjeçari në Lushnjë! PD mohon përfshirjen, dosja në SPAK (EMRI+VIDEO)

Sokol Dema

14 Prill, 09:20

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje